



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË
ARSIMIN E LARTË**

Nr. 95/17 Prot.

Tiranë, më 29.06.2018

LËNDA: Njoftim për vend të lirë pune

DREJTUAR: AGJENCISË SE PROKURIMIT PUBLIK
Shërbimi Kombëtar i Punësimit

TIRANË

Në zbatim të Vendimit nr. 109, datë 15.02.2017 të Këshillit të Ministrave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë" Urdhërin e Kryeministrit Nr. 171 datë 27.09.2010 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë", dhe në VKM Nr.143 datë 12.03.2014 "Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të levizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët e të mësim drejtues", Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), shpall njoftimin për 1 (nje) vend të lirë pune në pozicionin e **Përgjegjës i Sektorit të Statistikave dhe Analizave.**

Të interesuarit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

I. Kërkesa të përgjithshme për kandidatin:

1. Të ketë përfunduar arsimin e lartë dhe të zotërojë një diplomë universitare të paktën Master Shkencor ose ekuivalent me të, me notë mesatare të të gjitha niveleve të studimit mbi 7 (shtatë).
2. Të ketë përvojë pune të paktën 5 vjetare në profesion.
3. Të ketë përvojë pune në arsimin e lartë ose në institucionet që lidhen me arsimin e lartë, preferohet përvoja në ASCAL.
4. Të zotërojë gjuhën angleze me dëshmi, të ketë njohje të mirë në të shkruar dhe folur të gjuhës angleze.
5. Të dëshmojë aftësi të mira drejtuese dhe organizative.
6. Të ketë njohuri të mira kompjuterike në programet bazë.

II. Kërkesa të veçanta për kandidatin:

1. Të ketë njohuri të përgjithshme për administratën publike dhe drejtimin e institucioneve të saj.
2. Të ketë njohuri për legjislacionin bazë të arsimit të lartë në përgjithësi dhe atij që lidhet me cilësinë.
3. Të ketë njohuri mbi institucionet e arsimit të lartë, procedurat, kriteret dhe aktet nënligjore të sistemit të vlerësimit të cilësisë.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë; Tel: +355(0)2243423/2266203;
web: www.ascal.al; e-mail: info@ascal.al

4. Të ketë njohuri teknike dhe praktike në menaxhimin e proceseve të vlerësimit .
5. Të ketë njohuri dhe aftësi praktike në përdorimin dhe zbatimin e programeve statistikore për analiza, krahasime, rankime.
6. Të ketë dhe dëshmojë aftësi të mira të drejtimit, bashkëveprimit dhe aftësi në shkrim dhe komunikim.

III. Dosja e aplikuesit duhet të përmbajë:

1. Jetëshkrimin (*Curriculum vitae*)
2. Kërkesën me shkrim dhe kontaktin personal
3. Diplomën dhe listën e notave të noterizuar
4. Dëshmi të kualifikimeve pasuniversitare të kryera apo në proces
5. Fotokopjen e librezës së punës; e noterizuar
6. Dëshmia e gjuhës angleze/huaj e noterizuar
7. Fotokopje të dëshmive të kualifikimeve të kryera, të noterizuara
8. Vlerësime pune nga punëdhënësi/t e mëparshëm.
9. Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet me sistem pikëzimi, mbi bazën e dokumentacionit, njohjes së aftësive kompjuterike dhe gjuhës së huaj dhe përmes një interviste në prani të një komisioni të ngritur posaçërisht për këtë qëllim.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë ASCAL dosjen me dokumentacionin e kërkuar deri më datën 20.07.2018, ora 12.00 në adresën e mëposhtme;

Mund të aplikojnë edhe kandidatë që janë pjesë e stafit të ASCAL. Për këta kandidatë kërkohet plotësimi i dokumentacionit sipas pikës III ose përditësimi i atij ekzistuese.

**Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.
Rruga e Durrësit, pranë Gjimnazit “Qemal Stafa”
Tel: 4 22 43 423**

- Njoftimi të bëhet edhe në web site e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë;

www.ascal.al

DREJTORI

Dhurata Bozo

